



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1804 Regj  
Nr.28 Prot

Tiranë, më 10.01.2022

**URDHËR**  
**“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”**

**Drejtuar:** Qendra Kombetare e Biznesit  
**Adresa:** Tirane  
**Per dijeni:** Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A  
**Adresa:** Fier,Strum,fshati Strum ,Rr. Nacionale Fier –Berat,km.18,godina nr.2/1 Tel :0693575344  
**Per dijeni:** Shoqeria “Pik Industry” sh.p.k. NIPT L44324401A  
**Adresa:** Autostrada Lushnje Fier Km 1 .

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.62-2021-5386(1412), date 08.11.2021, i Gjykates së Rrethit Gjyqësor Fier, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1804, Datë 22.11.2021 kërkesën e kreditorit Shoqeria “Pik Industry” sh.p.k. NIPT L44324401A ndaj debitorit Shoqeria “Erjoni – Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fatura tatimore e shitjes Nr. 185, date 26.03.2021”.

Pas kryerjes së Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të detyrimit dhe fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm, referuar neneve 517 dhe 527 të K.Pr.Civile,

**me Shkresën Nr. 3484 Prot, datë 09.12.2021 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative** mbi aktivet e pales debitore Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, me qëllim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do të sillte ndryshime në regjistrin tregetar.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

**KONSTATOVA:**

Se pas verifikimeve të llogarive bankare rezultoi se detyrimi është ekzekutuar teresisht.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

**URDHËROJ:**

- Heqjen e masës së Sekuestros Konservative**, të vendosur me anë të shkresës Nr. 3484 Prot, datë 09.12.2021, mbi aktivet e pales debitore Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, me qëllim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do të sillte ndryshime në regjistrin tregetar.
- Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

**ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”**  
**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ERIS SOTIRI**